

KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

KEVIN CONSTRUKSION SHPK

**Pasqyrat Finanziare Individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor
2021**



Pasqyra individuale e pozicionit finanziar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 1 – 11 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

1. Informacion i pergjithshem

KEVIN Construksion sh.p.k. (referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si shoqeri me perqjejesi te kufizuar e regjistruar ne Regjistrin Tregetar me Nr. 36731 me daten 13.12.2016 dhe me Degen e Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT K71401004W.

Ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit, aktiviteti i Shoqerise konsiston ne fushen e sipermarjes se ndertimit me fonde publike etj.

Shoqeria zoterohet nga nje ortak , Z.LAVDRIM GJICI , ortak I vetem ne masen 100% te kapitalit .

Vlera e kapitalit : 88,692,102 leke.

Me 31 dhjetor 2021 perfajesuesi ligjor i Shoqerise eshte z. Lavdrim Gjici . Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2021 eshte 92 te punesuar . Adresa e Shoqerise eshte : Rruga Adem Jashari ,Ndertesa 4 , Hyrja 10,Njesia Bashkiake Nr. 5,Tirane.

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave

2.1 Perputhshmeria

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006 ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 te ndryshuar me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006 dhe me kërkesat e ligjit nr.25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme te viti 2020 shoqeria i krahason me te dhenat e vitit ushtrimor 2021.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin o tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme janë aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqe 11 qe jane pjesa perberese e pasqyrave financiare



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

3.1 Investime ne shoqerite e kontrolluara

Investimet ne shoqerite e kontrolluara kontabilizohen mbi bazen e metodes se kostos. Ato njihen fillimisht me kosto, dhe me pas zhvleresohen per te reflektuar vleren e realizueshme te investimit. Humbja nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kosto e investimit perfshin te gjitha kostot e transaksionit.

3.2 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlore te drejte rikembehesh ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aseteve dhe detyimeve monetare ne monedhe te huaj Jane:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Euro/Lek	120.76	123.7

3.3 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga kerkesa per t'u arketuar, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe detyime per t'u paguar.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlore te drejte nepermjet filim/humbje, kostot e transaksionit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njoftues fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument finanziar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadowne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivit financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financier tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilin shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadowne, shfuqizohen ose anullohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigioni per zhvleresimin e kerkesave per t'u arketuar llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia

qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financier dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohet tregues qe kerkesat per t'u arketuar te zhvleresohen. Shuma e provigionit llogaritet si diferenca midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

normen efektive te interesit.

Detyrime per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena nijnihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njoftes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njoftur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve qdo difference midis kostos dhe vleres se pagueshme nominale per gjate periudhes se huamarries duke u bazuar ne interesin efektiv.

Vlera e drejte

Vlerat e drejta te perllogaritura te mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre, te kerkesave per t'u arketuar, detyrimeve per t'u paguar dhe huave perafrohen me vlerat e tyre kontabel.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur qdo humbje nga zhvleresimi.

3.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, qdo kosto i tjetër te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kostot e çmimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkatese sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjata material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe kelo perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale nijnhet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundur qe shoqeria do te realizoje perfilime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale nijnhen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar te qdo pjese te aktivit afatgjate material duke filluar nga data e venies ne pune. Aktivet e marra me qira amortizohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit mbi jeten e vleresuar te qdo pjese te aktivit afatgjate material dhe duke marre per baze periudhen me te shkurtër midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe perqindjet e amortizimit per secilen kategori aktivesh afatgjata per periudhen aktuale jane si me poshtë:

Ndertesa	Mbi vleren kontabel neto	5%
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mobilje dhe orrendi	Mbi vleren kontabel neto	



*KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)*

Pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%
Te tjera active	Mbi vleren kontabel neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi.

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale qe kane nje jete te percaktuar malen me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humjet e akumuluara nga zhvleresimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes se aktivit. Shuma e amortizimit kalon ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne menyre zbritese per gjate ijetes se aktivit.

3.6 Zhvleresimi

(i) Aktivet finanziare

Nje aktiv finanziar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa nqiarie kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin finanziar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivet e tiera financiare vleresohej ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te përiashme te rrezikut.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumular i lidhur me një aktiv financiar i disponueshem per shifre i rjohur me pare ne kapital, njihet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njoftes se humbes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja nijhet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivitet iofinansiare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te shoqerise, rishikohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhylteresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Inventari

Inventarlet percaklohen me vleren me te vogel midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kostoja percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera per perfilitimin e inventarit dhe kosto te tjera te kryera per dergimin e inventareve ne destinacion dhe me kushtet e kerkuara. Vlera e realizueshme neto eshte çmimi i llogaritur i shitjes ne aktivitetin normal te biznesit duke zbritur shpenzimet variabel te shitjes.

3.8 Provisioner

Nje provijon njihet nese, si rezultat i nje ngjarje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohej ne menyre te besueshme dhe do te kerkoste flukse dalese parash per shlyerjen e tij.

Provigionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per rreziqet qe lidhen me detyrimin ne fiale.

3.9 Njohja e te ardhurave

Shitja e mallrave

Te ardhurat nga shitja e mallrave gjate rrjedhes normale te biznesit maten me vleren e drejte, duke zbritur kthimet e mundshme te mallrave, zbritjet tregetare dhe rabatet. Te ardhurat nijhen atehere kur rreziqet qe perfitimet e rendesishme jane transferuar tek bleresi, marrja e shembimit eshte e sigurt, kostot perkeqese ishte dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te vleresohej ne menyre te besueshme, nuk ka parashirje te



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

shitesit ne menaxhimin e mallrave, si dhe shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri.

Shifja e sherbimeve

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara nijhen ne pasqyren e te ardhurave ne varesi te fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e bilancit. Asnjë e ardhur nuk nijhet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatose.

3.10 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe nijhen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi nijhen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlore te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes nijhen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes, i cili nijhet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatushme te viti, duke perdorur normat tatimore te miratuara ne periudhen e raportimit.

4 Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 perbehen si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020
Llogari rrjedhese:		
Lek	172,388,525	274,065,340
Euro	172,388,525	274,065,340
Arka:		
Lek	1,041,466	1,042,368
Euro	1,041,466	1,042,386-
TOTALI	173,429,991	275,107,726-

5. Te drejta te arketueshme

Kerkesat per t'u arketuar me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 perbehen si me poshte:

	Viti I mbyllyr me 31 dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020
Nga aktiviteti I shoqerise	398,399,251	371,137,646 -
TOTALI	398,399,251	371,137,646-



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

Te arketueshme te tjera detajohen me tej si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020
Te tjera	7,837,699	72,733,241
TOTALI	7,837,699	72,733,241

Shuma **7,837,699** leke per Vitin 2021 perbehet nga shuma 2,400,000 leke e cila tregon shumen e ngrutesuar ne banken credins si garanci per proceset e tenderave, shuma 528,864 leke pagesa ndaj Komisionit te Prokurimit Publik per ankimim tendera, shuma 1,327,401 leke parapagim per shoqerine Mela sh.p.k per pune qe do kryhen, shuma 3,581,434 leke tregon tepricen kreditore te TVSH – se .

6. Inventaret

Inventari i Shoqerise me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 perbehet si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020
Materiale Ndihmese	0	0
Parapagime per inventar	0	0
TOTALI	0	0

Lenda e pare perbehet nga gjendja e materialeve te para ne fund te vitit te vleresuara me mesataren e ponderuar e cila per kete vit eshte zero.

7.Detyrime afatshkurtre

Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 perbehen si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020
Arketime ne avance per porosi	0	73,972,800
Detyrime ndaj instituc te kredise (overdraft)		0
Furnitore	311,029,454	471,257,802
Te tjera te pagueshme	77,470,000	22,470,000
Te pagueshme ndaj punonjesve	19,714,521	10,604,329
Te pagueshme per detyrime talmire	4,088,178	3,119,382
TOTALI	412,302,153	581,424,313

8.Te ardhura nga shitja e mallrave

Pasqyra individuale e pozicionit finanziar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpieguese ne fejet 11 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

Te ardhurat nga shitja e sherbimeve gjate vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2020
Te ardhura nga shitja e sherbimeve	1,329,549,321	1,238,398,351
TOTALI	1,329,549,321	1,238,398,351

Shuma 1,329,549,321 leke e te ardhurave e deklaruar ne PASH nuk perputhet me shumen 1,255,576,521 leke te deklarimeve te FDP ne sistemin talimor ne vlore 73,972,800 leke, pasi kjo vlore eshte deklaruar si **paradhenie** per arketime ne avance per kryerje te punimeve dhe nuk eshte perfshire ne te ardhurat e vitit 2020 tek PASH, por eshte pasqyruar si kliente kreditore tek pasivi i bilancit. Paradhenie eshte e percaktuar ne **kontraten me Institucionin Fondi Shqiptar I Zhvillimit per ndertimin e shtepiave nga termeti**. Ne vitin 2021 keto punime u realizuan dhe paradhenia u mbyll me situacionin perkates duke e shtuar si te ardhur te tatueshme per vitin 2021.

8/1. Te ardhura nga interesat ne llogarite bankare

Te ardhurat nga interesat ne llogarite bankare gjate vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2020
Te ardhurat nga interesat	5,175,344	6,196,632
Te ardhura te tjera	0	0
TOTALI	5,175,344	6,196,632

9 Kosto e materialeve te blera.

Kostoja e blerjes se lendet se pare dhe materialeve ndihmese te prodhimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 eshte respektivisht 81,616,814 leke dhe 53,102,407 Leke.

10 Shpenzime te personelit.

Kostoja e punes gjate vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 eshte si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2020
--	--------------------------------------	--------------------------------------

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 11 qe jane pjesa perberese e pasqyrave financiare



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

Pagat e personelit	35,996,385	34,527,742
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	4,313,150	4,025,375
TOTALI	40,309,535	38,553,117

11 Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2020
Trajtime te pergjithshme	1,137,551,684	1,094,707,044
Qira	648,000	648,000
Mirmbajtje dhe riparime	543,644	1,356,175
Te tjera	157,548	466,864
Auditim e sherbim kontabel	730,000	180,000
Sherbime interneti	196,874	182,305
Shpenzime noterizime	404,433	571,115
Shpz. Per kurse punonjesish Isso,IQT	120,500	239,260
Shpz. Per transport blerje	238,398	0
Shpz. Per siguracione	850,172	3,070,234
Shpz. Per ankesa tek KPP	1,536,247	202,004
Shpz. Postare e telecom	103,270	92,418
Shpz.prova laboratorike	1,458,000	145,000
Shpenzime bankare	394,694	129,035
Shpz. Interesi ovd	0	2,790,650
Taksa e rregjistrimit	84,818	107,500
Taksa per bashkine	261,680	136,060
Vlera neto e AQT te shitura	1,458,333	0
Gjoba dhe demshperblime	132,392	37,190
TOTALI	1,146,870,688	1,105,060,854

12 Shpenzime Financiare

Te ardhurat (shpenzimet) nga kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jane si me poshte:

Pasqyra individuale e pozicionit finanziar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 1 - 11 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

	Viti i mbyllur me 31dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2020
Fitime te realizuara nga kursi i kembimit	77,293	0
Fitime te parealizuara nga kursi i kembimit	-	-
	77,293	0
 Humbje te realizuara nga kursi i kembimit		
Humbje te parealizuara nga kursi i kembimit	0	1,160,773
	0	1,160,773
TOTALI	77,293	1,160,773

13 Tatim-fitimi

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin eshte 15% per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

Deklaratat tatimore dorezohen qdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane 16iscal interpretimi nga autoritetet tatimore.

Rakordimi i rezultatit kontabel me rezultatin 16iscal

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2020
Fitimi (humbja) e kontabel e vitit	60,879,851	42,062,888
Rregullime:		
Shpenzimet e panjohura	132,392	37,190
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	61,012,244	42,100,079

Shpenzimet e panjohura jane ne vleren 132,392 leke .

Shpenzime Tatim Fitimi 9,151,837 leke ka rezultuar pas illogaritjes se fitimit te taksueshem , mbasi kemi zbritur kestet e tatim fitimit te paguara gjate vitit 2021 ne vleren 5,071,759 leke na ngelet nje difference 4,080,078 leke tatim fitim per te paguar .

14 Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021, Shoqeria nuk ka çeshtje apo pretendime qe do te kene efekt negativ ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 dhjetor 2021, Shoqeria nuk ka angazhuar kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.



KEVIN Construkcion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar
me 31 dhjetor 2021
(ne leke)

15. Palet e lidhura

Transaksionet dhe gjendjet me ortaket qe jane pale e lidhur me Shoqerine, kane te bejne me hua ndaj Shoqerise apo te drejta te krijuara gjate zhvillimit te aktivitetit te saj (shih shenimet 1, 5 dhe 10)

16. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

ADMINISTRATORI



FINANCIERE

MAJLINDA DIMO